

VENDIM
Nr. 541, datë 25.7.2019

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 137, DATË 28.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN E TASK-FORCËS PËR EVIDENTIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE GJATË BREGDETIT SHQIPTAR, ME QËLLIM INVESTIMIN NË TURIZMIN BREGDETAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 137, datë 28.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 11, shtohen pikat 11.1 dhe 11.2, si më poshtë vijon:

“11.1 Task-Forca monitoron, mbikëqyr dhe ndjek në kohë reale të gjitha ndryshimet, përditësimet, regjistrimet, si dhe çdo veprim tjetër të kryer nga organet shtetërore në lidhje me pasuritë e paluajtshme shtetërore, të cilat ndodhen brenda fashës 1.5 km nga vija bregdetare.

11.2 Institucionet dhe organet e përmendura në pikën 11, të këtij vendimi, vënë në dijeni Task-Forcën në lidhje me të gjitha zhvillimet dhe ndryshimet që do të ndodhin në statusin juridik të pasurive të paluajtshme shtetërore përgjatë vijës bregdetare, sipas pikës 11.1 të këtij vendimi.”.

2. Në pikën 12, fjalët: “... deri në datën 31 korrik 2019.” ndryshohen në: “... deri në datën 31 dhjetor 2019.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama